



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Nr:1	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Data e mbajtjes:	27.02.2025 Ora: 10:20
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKS-së
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;</li><li>2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;</li><li>3. Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame;</li><li>4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,</li><li>5. Jerej Nebojša Sekulliç, Kisha Ortodokse,</li><li>6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;</li><li>7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;</li><li>8. Adnan Ramić, Komuniteti Boshnjak;</li><li>9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;</li><li>10. Ukë Dolci, Komuniteti Egjiptas;</li><li>11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;</li><li>12. Servete I Iaxhijaj, Zyrtarë për barazi gjinore;</li><li>13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;</li><li>14. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;</li><li>15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;</li><li>16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;</li><li>17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</li><li>18. Blendincta Shatri, EVSB;</li><li>19. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;</li><li>20. Almina Eqo, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;</li><li>21. Blendor Isufaj, KVRI;</li><li>22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";</li><li>23. Lumdita Idrizaj, HFNDIKOS;</li><li>24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe</li><li>25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.</li></ol>
	<b>Mungojnë:</b> Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame

Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,  
Jerej Nebojsa Sekulic  
Enver Boletini, KLSP, Gurakoc  
Gëzim Ademaj, KLSP, Banjë  
Armir Arifaj, SH.K.K Burgu i Dubraves  
Komuniteti i Biznesit

**Pjesëmarrës tjerë:**

Francesco co Vaslo, KFOR  
Nikelina Franca, FSK  
Bahrije Muqa, OSBE  
Gjyldane Ahmeti, OSBE  
Safet Blakaj, OJQ " Labirinti"  
Endrit Mehmetaj, RTV Fontana  
Blerim Gerguri, përkthyes, Komuna Istog  
Mehmed Qeman, përkthyes, Komuna Istog  
Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit, Komuna Istog  
Lirije Demiri, Komuna Istog  
Kryetaret e Këshillave të Prindve dhe Këshillave të  
nxënësve nga 13 Shkollat e Komunës  
Drejtor të Shkollave dhe Psikolog

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Sh.K.K "Burgu i Dubraves", Përfaqesues të komuniteteve etj.)
5. Konsumimi i drogave, tabaqeve dhe alkolit nëpër shkolla-teritorin e Komunës
6. Të ndryshme

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Përsëndet të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të prënishmit. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Para se ta hudhi në votim rendin e ditës më lejoni të theksoj se përveç Imamit Shemsedin Zymbceraj dhe Jerej Nebojsa Sekuliq asnjë anëtar tjetër nuk kanë lajmruar për arsyetim të mungesës në takim. Konstatohet se nga 24 anëtar të KKSB-së, të prënishëm janë 18 anëtar dhe kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës pos këtyre që i lajmroj.

Me qe nuk ka propozime tjera, miratohet rendi i dites unanimisht.

## 2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Pyet anëtarët e KKSBB-së të pranishëm në mbledhjen e kaluar a ka dikush vrejte në ekstraktin e procesverbalit. Me qe nuk ka vrejte, miratohet ekstrakti i procesverbalit unanimisht.

Kalojm në pikën e tretë të rëndit të ditës.

## 3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon zv. komandantit të Policisë.

**Tog. Qazim Jahaj Zv. Komandant i St. Policisë Istog** - Situata në zonën e përgjegjësisë është e qet dhe stabile. Këtë koh kemi punu në plane operative Siguria në Shkolla, Siguria ne komunikacion etj, dicka tjetër të posaçme nuk ka.

**Gjulla Karishik, Komiteti për Komunitete-** kamë vrejte nga qytetaret që në Rr. Sarajeva në Llukavc të Begut është krijuar një deponi ilegale andaj kerkoj që e njëjta të eliminohet dhe mundsisht ajo pjes të rrethohet për të parandaluar hedhjen e mbeturinave në vazhdim.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - kemi diskutuar edhe në të kaluaren lidhur me deponit, nuk e kemi sot Drejtorin e SHP, por kërkuesen tuaj do ta procesojmë Drejtorin e SHP dhe e njëjta do te trajtohet.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** në fund të fsh. Tomoc është duke u ngritur një deponi ilegale, a i përciell dikush nga institucionet, a ka fletparaqitje apo gjoba për hudhesit e mbeturinave.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - përmes Drejtoris SH.P kompanis Ambienti dhe Drejtoris së Inspektionit bëhet mbikqyrja e drejtperdrejt dhe ka raste kur Inspekcioni shqipton gjoba kur dihet apo nxinet pala duke hedh mbeturina. Shfrytzoj rastin që përmes mediumit RTV Fontana që është prezent tju bëj thirrje gjithë qytetarve që bashkarisht të kontribojm në rruajtjen e ambientit. Mesazhi jon është që mos ta pastroj oborrin dhe ti hudhim mbeturinat sepse keshtu e ndotim ambientin dhe shkaktojm rrezik të përgjithëshem, gjithashtu ju bëj ftes gjith juve anëtar të KKSBB-së dhe qytetar të pranishëm që rastet ti paraqitni në Drejtoratin e Inspektionit kur jeni ne dijeni kush i ka hedh. Drejtorati i Inspektionit ka sqaru para këtij Këshilli se ka pas raste kur kanë shqiptu gjoba për ndotësit e ambientit në ato raste kur është dit kush i ka hedhur, por nuk është Inspekcioni në detyr 24x7 dhe në çdo hapsir të Komunës së Istogut që ta di kush po i hedh mbeturinat, ndersa në anën tjetër edhe pse ka një bashkpunim më të mirë qytetar-Polici-Inspektorat ende nuk është në nivelin e duhur që të paraqesim rastet edhe pse nga njëher i din mirë kush është keqbersi. Pra për keto arsye ka nevoj që të punojm ma shumë.

Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pik kalojm në piken e katert të rëndit të ditës.

## 4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqesues të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës , Perfaqsesit e KFOR-it, FSK-së, Arsimit etj fjala është për ju.

Perfaqsesi i FSK-së- vlersimet tona perkojn me vlersimin e Policisë se gjendja në zonen e pergjegjesis tonë, gjegjesisht në Komunën e Istogut është e qetë dhe stabile, me çrast deshiroj ti falenderoj gjithë qytetaret dhe institucionet për në bashkëpunim të ndersjellt dhe theksoj se FSK-ja është e gatshme për të vazhduar dhe zgjeruar një bashkëpunim të till.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon perfaqsesin e FSK-së, me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pik kalojm në pikën e pestë të rëndit të ditës.

## 5. Konsumimi i drogave, tabaqeve dhe alkolit nëpër shkolla-teritorin e Komunë

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - ftoj Z. Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti qe ta paraqes nje raport lidhur me konsumimin e drogave ne Kosovë, rrjedhimisht krahasimin e Komunes së Istogut me komunat tjera ekuivalente.

Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti- Drogat janë të ndryshme por ajo që është më e perhapura në teritorin e Kosovës është Marihuana. Sipas statistikave në Kosovë edhe pse mund të konstatojm se nuk janë 100% të sakta por keto i disponojm në Kosovë janë rreth 42.000 perdorues të drogave. Ne i ndajm në dy grupe dhe atë: perdorues të drogave, kjo kategori janë perdorues të kohëpaskoshme, pra jo të rregullt dhe kategoria e dytë; perdorues problematik dhe në këtë kategori kemi 12-14.000 pra kjo kategori janë perdorues të mvarur nga drogat të cilët bien ndesh me Ligjin, konflikt me familjen dhe rrethin shoqëror. Moshë mesatare e perdoruesve ka qen 35-45 vjet ndersa nga viti i kaluar kjo mesatare ka rën 25-27 vjet. Mvarsia nga droga është tejet e shpejt dhe po që se nuk zbulohet në stazat fillestare të perdorimit atëhere mvarsia bëhet problematike dhe kryesisht këta perdorin tipin e droges Kokain. Kjo është droga më e shtrejt deri me tani.

Natyrisht se ne bëjm ndarjen në regjione dhe këtu prinë Regjioni i Prishtinës, natyrisht për shkak të dinamikave të zhvillimeve në Kryeqytet. Perpara ka qen Gjilani si regjioni i dytë për kah perdoruesit tani si regjion i dytë është Ferizaji ndersa Gjilani ka rën në vendin e tretë , e pasuar nga Mitrovica ku hyjn edhe perdoruesit nga Mitrovica e Veriut dhe veriu në pergjithësi.

Ajo çfar është fokusi i këtij takimi është Regjioni i Pejës. Sipas statistikave Peja ka numrin më të vogël të perdoruesve, megjithatë ne kemi të dhëna të besueshme nga terreni që tregojn tjera shifra në krahasim me statistikën, por scrish janë më të ulta se në regjionet tjera, megjithatë këto të dhëna tregojn se po ndodh diçka e keqe edhe në Regjionin e Pejës.

Kur e analizojm Regjionin e Pejës tani na intereson ku qendron Komuna e Istogut dhe ta bëjm një krahasim të Komunës me Komunat në tër Kosovën.

Istogu dhe Dragashi janë dy komunat që kanë numrin më të vogël të perdoruesve të drogave në Kosovë. Nëse e krahasojm Istogun me Lipjanin si dy Komuna perafersisht të madhësis së njëjt, na del se Lipjani ka numer shumë më të madh të perdoruesve dhe kjo për arsyen që Lipjani graviton ma afer Kryeqytetit dh kjo ka ndiku në përhapje më të shpejt. Para dy viteve kemi vrejt një dukuri të çuditshme

perhapjen me shpejtsi enorme tek Komunitetet RAE në Fush Kosovë, Gjilan, Prizeren etj, qe na bën me dije që nuk janë ma vetem shtresat e pasura fokus i shperdarsëve të drogave.

Në Istog i kemi disa raste të perdoruesve të Kokaines, kur këto raste i krahasojm me komunat tjera nuk paraqesin shqetsim si statistik edhe pse deshira është të ket zero perdorues të drogave. Fokus i jonë kryesor është në parandalimin e perdorimit të drogave, jemi në perpjekje të vazhdueshme që së bashku me strukturat Nacionale të hartojm strategji dhe sistem të parandalimit të perdorimit të drogave, shpresojm që së shpejti të arrijm deri te ky program. Në këtë aspekt gjithnjë fokusi ynë është siguria në Shkolla. Para 15 vitesh moshë mesatare e fillimit apo perdorimit per her të par të urogës ka qen mbi 21 vjet. Tani kjo moshë ka ra në 16 vjet, në disa raste ekstreme kemi numer të vogël edhe me 12 apo 13 vjet por janë raste simbolike. Rreziku më i madhi tani është nga moshë 15-17 vjet dhe fokusi jonë është kjo grupmosh. Kur flasim per këtë grupmosh domosdoshmerisht permendet Shkolla me qe kjo kategori janë ende në Shkolla, por berdorimi bëhet edhe jashta Shkollave dhe gjithnjë shtrohet pyetja pase spo ndermarrim diçka në Shkolla. Synimi është që ti pergatisim Psikologët e Shkollave, zyrtar në QPS-të që të mbahen ligjerata neper shkolla dhe të jen më të pergatitun që nga afer të vrejndryshimet dhe zbulimet e horshme eventuale apo si e quejm ne profesionalisht " Identifikimi i hershear i perdoruesit të droges" gjë që rirundson marrjen e masave në sherimin e hershem që është ma i leht.

Identifikimi i vonshem i perdoruesit të drogave krijon veshtersi në marrjen e masaveqofshin ato represive qofshin sheruoc. Per fillim kaq jam i gatshem tju pergjigjem pyetjeve.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** pas identifikimit si e beni trajtimin e perdoruesve të drogave, a i dergoni në sherim apo cili është tretmani i më tutjeshem. A organizoni ligjerata neper shkolla në këtë tem në nivel vendit.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** kur janë në pyetje moshat e reja gjegjesisht nxënës të Shkollave, faza fillestare është permes prindërve dhe QSP-së. Natyrisht se duhet të bëhet një vlersim për llojin e droges së përdorur, kohëzgjatjen e perdorimit dhe kjo nuk mund të arrihet vetem me vlersime psikologjike por kerkon edhe vlersime biologjike, në organizaten tonë nuk kemi trajtim terditor por vetem permes seancave. Nese nuk kan simptome psikologjike athere vie në shprehje vetem intervenimet mjeksore që të bëhet pastrimi i trupit, ndersa në raste të rënda mvarsie dhe problemeve psiqike ather duhet trajtimi hospitalor dhe kemi bashkpunim me qendrat psikologjike. Ndersa qëndrave per trajtim afatgjat ju ikin edhe vet pacientet gjegjesisht perdoruesit e drogave sepse edhe ata janë të vetëdijshëm se mund tia dalin edhe me metoda tjera. Edhe Evropa është duke ju ikur qëndrave afatgjate të trajtimit sepse vet perdoruesit po ju ikin ketyre qëndrave.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** a keni organizu me DKA-në e Istogut apo a keni mbajt ndonjë ligjerat në Shkollat e komunës së Istogut.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** ne jemi të hapur për gjith ata që na ftojn per ligjerim, por me vetorganizim nuk kemi bër sepse i kemi kapacitetet e limituara. Si e thash edhe më heret tani fokusi i jon është hartimi i strategjis dhe i planit të veprimit në nivel vendi që programi të jet i njëjt për gjith vendin dhe rezultatet e ketij programi

mund të shihen dikim mbas 4-5 vjetve, nuk ka mundsi asnjë program të ket ndikim të menjehershëm nese nuk ka vijimsi.

Ukë Dolici, perfaqsoes i Komuniteti Egjiptas- e permendet komunitetin RAE si perdorues në kohen e fundit pyetja a jënë qytetar të kthyer nga perendimi apo janë vendas nese mund ti quaj ashtu, a ndermerr Policia masa.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** një pjes e tyre janë të kthyer nga vendet perendimore, shqetsimi jonë kryesor është shembull numri i madh i perdoruesve në Fushë Kosovë dhe Plemetin që per një koh shumë të shkurt ka marr permasa shqetsuese, sepse nuk kemi prit që aty të ket perdorues të Heroines per vetëm njëvit e gjysem 72 persona si perdorues të rregullt ka qen tejet shqetsuese sikur të kishin qen vetëm perdorues të Marihuanes edhe nuk do të ishte aq problem per neve. Sepse ky është komunitet tejet i vogel. Pjesa më e madhe e tyre janë kyq në programet tona, dikun 58 prej tyre janë në programet tona rehabilituese.

**Zenun Blakaj, perfaqsoes i Komunitetit Shqiptar-** prezantohet per të pranishmit, nuk e di a është kompetenc e juaja apo a keni njohuri per kanalet e furnizimit, a janë të identifikueshme grupe të organizuara trafikantësh, a mund të bëhet ndërprerja e këtyre kanaleve dhe pyetja e dytë a mund të bëhet kategorizimi i grupeve si shtresa shoqërore gjegjësisht të pasur të mesme apo të varfëra.

A ka Kosova kapacitete të mjaftueshme për trajtimin e perdoruesve të drogave per ti rehabilituar, per ti kthyer në bashkëpunëtor per parandalimin e perdorimit të drogës dhe a ka statistika per trendin a është në rritje apo si qendron gjendja.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** Trendi mvaret sipas llojit të Drogave, ka vit që perdoret një lloj ndersa tjetri vit është tjetra drog, sidoqoft trendi i pergjithshëm është në rritje, bile në rritje të shpejt dhe është shumë afer nivelit që të bëhet alarmante. Perdoruesit e Heroines i kemi nën vëzhgim dhe kontrollë, perdoruesit e marihuanes dhe kokaines nuk i dim dhe nuk i kemi në kontroll.

Sa i perket trajtimit po me trajtim merret Labirini, kemi Klinika private, qendra tjera rehabilitimi në komunitet dhe sa i perket rezultateve krejt mvaret nga programi që e ndermerr çdo njëra nga këto qendra. Ndersa sa i perket shtresave sociale, viteve të fundit gjithçka ka ndryshu, pa marr parasysh shtres sociale apo ekonomike tanimë të gjitha janë target grup. Edhe Familja funksionale apo mirë e organizuar një dit e vren fëmijun si perdorues njëjt si ato familjet më dobët të organizuara, e kur vjen çeshtja te trajtimi ather kemi lehtësi në trajtim tek familjet e mirë organizuara.

Nuk kemi has grupe të strukturuara të trafikantëve të drogave. Droga Heroina ka ardh nga Turqia në Ballkan dhe per Evrop, Kokaina dhe kanabisi janë më të shtrejta dhe pak konsumohen tek ne, kryesisht janë vetem si rrug kaluese per Evrop. Pra janë kryesisht individ që trafikojn nga jashta dhe piksynim e kan Evropën. Çeshtja është sa janë këta trafikant të inkriminuar në rrjetet egzistuese në Evrop, sa ndikojn njëni të tjetri, unë nuk jamë njohës i mirë i fushës së siguris por këto janë njohurit tona.

**Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës -** e falenderon shumë z. Blakaj per një ekspozim të detajuar dhe është shpresëdhënëse që Komuna e Istogut qendron relativisht mirë në krahasim me Komunat barazvlefshme edhe pse kjo nuk duhet që tna jep komoditet në veprimet tona por do të fokusohemi që kjo dukuri në Komunën ton mundsisht të çrrënjoset fare. Gjithashtu falenderoj gjithë akteret tjer që nderlidhën në veprimtarin e identifikimit, sherimit dhe parandalimit, me që nuk ka pyetje tjera kalojm në pikën e gjashtë të rendit të ditës të ndryshme.

## 6. Të ndryshme

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** -pyet a ka dikush të ngris ndonjë çeshtje jashë rendit të ditës.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** kamë informacione që janë të rritura faturat e energjis elektrike per keta dy muej. Pyetja a ndermerr ndonjë veprim institucionet komunale apo Stacioni Policor i Istogut.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - institucioni pergjegjes per faturimin e energjis elektrike KFSCO-KEDS që është kompani private e cila faturon dhe mbledh mjetet buxhetore per energjin e shpenzuar në republiken e Kosoves. Ne si institucion mundemi vetem te adresojm problemin se bashku me qytetar dhe nuk kemi ndonje kompetenc tjetere.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** nese qytetari paraqet ankes dhe hap rast ne Polici, a e adreson rastin Policia ne Prokurori apo e len pa e procesu tutje.

**Tog. Qazim Jahaj Zv. Komandant i St. Policisë Istog** -ne rastin konkret ne i kemi dy opsione, fillimisht nese ka argumente per veper, Policia e kontakton Prokurorin dhe bazuar ne vlersimin e tij hapet rast apo Prokurori e vlerson se nuk ka argumente per te hapur rast por sugjeron qe pala te fillon procedur permes Gjykates si padi-konteks civil.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së-** Piken e pëstë të rendit të ditës që e patem sot është tem nga Plani i Punës të KKSB-së. Komisioni i KKSB-së që kemi qëm më vizita neper Shkolla ju kemi thën që qellimi është ngritja e bashkëpunimit të siguris në Shkolla. Gjatë bashkëbisedimit nëper Shkolla jemi informuar se si Këshill i nxënësve debatoni edhe per narkotik tabaqe e alkohoic dhe që Policia e Kosovës ligjeron tema të tilla. Sot isha pak i befasuar nga ana juaj dhe e Këshillave të Prindve dhe Psikologëve që nuk patët asnjë pyetje për z. Blakaj që është ekspert i lamis së drogave. Sa i perket Strategjis në nivel vendi propozoj që Kryetari i Këshillit të Prindve të paraqes shqetsimin e KKSB-së Istog në nivel Qendror dhe të paraqitet si kërkes për pershpejtimin e hartimit të Strategjisë gjegjesishtë programit të ligjeratave unike në nivel vendi dhe në mbledhjen e radhes ta njoftoj këtë këshill me pergjigjen nga niveli qendror. Nga ju Kryetar të Këshillave të nxënësve dhe prindëve kerkoj që në Shkollat e juaja ta perçoni mesazhin e dhën nga kjo mbledhje në parandalimin e perdoruesve të drogave.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** në nivel Kosove tanimë është e hartuar Strategjia dhe është valide por ajo është vetem në leter ajo çfar po perpiqemi të jetsojm është programi dhe mënyra e zbatimit të saj.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** per tu nderlidh me atë që kerkoj Skenderi, unë kam njohuri që ju keni bashkëpunim me Ministrin e Arsimit per mbajtje të ligjeratave të tilla.

**Safet Blakaj, Drejtor i OJQ " Labirinti-** po kemi një bashkëpunim por programi kerkon nderlidhje edhe të fushes së shendetsis, QPS-ve per tu funksionalizuar dhe per tu ber unike.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - me sa unë kuptova ajo çka Skenderi kerkoj që ju si nënkryetar i Këshillit të Prindve në nivel qendror ta ngritni zërin për zbatimin e Strategjis dhe të kerkoni një raport nivel vendi për zbatueshmerin e kesaj strategjie.

Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së- më lejoni që të falenderoj z. Blakaj për një paraqitje të detajuar lidhur me temën, njiheri më lejoni ti pershendes dhe ti falenderoj Këshillat e Nxënësve, Këshillat e Prindërve, Drejtor të Shkollave, Psikolog, Pedagog për punën e tyre sepse është kontribut i tyre dhe i Policisë së Kosoves me që Komuna e Istogut gjegjësisht Shkollat tona qendrojnë mirë në nivel vendi, kjo nuk do të thot që perpjekjet tona të ndalojnë këtu por të vazhdojmë edhe me hapa më të shpejt për parandalimin e kësaj dukurie që shkatrron rinin dhe të ardhmen tonë. Pra e ardhmja është pa dukuri negative në institucionet Shkollore.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- në qender të Istogut janë tri objekte ku zhvillohen dukuri negative dhe paraqesin rrezik për siguri të qytetarve.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -Po i kemi evidentu këto objekte, por problemi egziston tek pronsija me qe disa janë pron e APK-së apo private dhe jemi në procedura të definimit të hapave dhe pergjegjësi të mëtutjeshme. Me qe nuk ka pyetje tjera më lejoni që në veçanti ti falenderoj nxënësit, prindrit Drejtorë, Psikologët dhe pedagogët e shkollave dhe gjithë të pranishmit për kontributin e dhën në këtë mbledhje. Mirupafshim në mbledhjen e radhes.

**Mbledhja perfundoj:**

11.55